



Planina / Detyra Punëpunë/Prudato Recursion/Duty	07.07.2022	2	viti god year
Organ/Njësia Organ/Department Org./Unit	Nr. Prot Pr. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIKIMSTICK	3980/2022		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr. 482/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga; Malsore Gashi – Bajraktari -kryetar, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.482/2022 të datës 26.05.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi, Komuna e Skenderajt, kundër organit të punësimit/Komuna e Skenderajt, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.07.2022, mori këtë:

### V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.482/2022 e datës 26.05.2022, e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Komuna e Skenderajt sipas njoftimit datës 20.01.2022 ka publikuar konkursin e jashtëm për grupin „Specialist i Administrimit të Përgjithshëm” për pozitën “Zyrtar për Gjendje Civile 1” në Drejtorinë për Administratë, me numër reference RN00008142 për afatin për aplikim nga data 10.02.2022 deri me datë 24.02.2022, në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi i cili ka marrë pjesë në të gjitha fazat e zhvillimit të procedurës së rekrutimit.

Me datë 26.04.2022, Komuna e Skenderajt, gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore ka publikuar njoftimin me numër protokolli 02-112-9208/01-00/8554/22 për rezultatet e vlerësimit për grupin „Specialist i Administrimit të Përgjithshëm” për pozitën “Zyrtar për Gjendje Civile 1” në Drejtorinë për Administratë, me numër reference RN00008142.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 26.04.2022, të Komunës së Skenderajt, gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore, me datë 25.05.2022 parashtron kërkesë me numër

protokolli 01-0023417/22, për qasje për shikimin e testit me shkrim tek Njësia e Burimeve Njerëzore pranë Komunës së Skenderajt

Ndërsa me date 26.05.2022, ankuesi ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 3054/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore që procedura e rekrutimit për grupin „Specialist i Administrimit të Përgjithshëm” për pozitën “Zyrtar për Gjendje Civile 1” me numër reference RN00008142 është zhvilluar nga Komuna e Skenderajt në kushte të pabarabarta pasi që Komisioni i Pranimit nuk i ka bërë vlerësimin e drejtë dhe objektiv si në kualifikim, përvojë profesionale në test me shkrim në krahasim me kandidatet tjerë, andaj propozon që ti aprovohet ankesa dhe të anulohet konkursi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 01.06.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Skenderajt, ndërsa Komuna e Skenderajt me datë më datë 13.06.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës .

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 3054/2022 të datës 26.05.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E- maili i datës 28.04.2022; E- maili i datës 31.05.2022; Renditja përfundimtare e kandidateve; Vendimi i datës 16.03.2022 për emërimin e komisionit; Njoftimi i datës 08.03.2022; Njoftim i datës 26.04.2022 për rezultatet e vlerësimit të kandidateve; Konkursi i datës 20.01.2022; Testimi elektronik; Vërtetim i datës 04.11.2019; Vërtetim i datës per 10.05.2019; Certifikatë e datës 10.06.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë; Diplomë e datës 20.03.2017; Certifikatë e datës 08.01.2013; Diplomë nr. 604 e datës 22.06.2009; Përgjigje në ankesë e datës 08.03.2022, me numër protokollit 02-112/01-0026019/22

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është palejuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në shkresat e lëndës të dorëzuara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankuesi me datë 26.05.2022 parashtron ankesën me numër të protokollit 3054/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që procedura e rekrutimit për grupin „Specialist i Administrimit të Përgjithshëm” për pozitën “Zyrtar për Gjendje Civile 1” me numër reference RN00008142 është zhvilluar nga Komuna e Skenderajt në kushte të pabarabarta pasi që Komisioni i Pranimit nuk i ka bërë vlerësimin e drejtë dhe objektiv si në kualifikim, përvojë profesionale në test me shkrim në krahasim me kandidatet tjerë, andaj propozon që ti aprovohet ankesa dhe të anulohet konkursi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës nën 31 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: “veprimin që kundërshtohet”.

Kolegji në bazë të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesi ka marrë pjesë në të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit për grupin „Specialist i Administrimit të



Përgjithshëm" për pozitën "Zyrtar për Gjendje Civile 1" me numër reference RN00008142 të shpallur nga Komuna e Skenderajt, dhe pas përfundimit të procedurës së rekrutimit për pozitën e lartcekur, me datë 26.04.2022, Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Skenderajt, ka publikuar njoftimin me numër protokoll 02-112-9208/01-00/8554/22 për rezultatet e vlerësimit respektivisht listën me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve ku rezulton se ankuesi është vlerësuar me gjithsej 58 pikë duke u renditur i dyti, ndërsa kandidatja fituese është vlerësuar me 82.8 pike.

Ankuesi kundër njoftimit të datës 26.04.2022 me numër protokoll 02-112-9208/01-00/8554/22 për rezultatet e vlerësimit përfundimtar për grupin „Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" për pozitën "Zyrtar për Gjendje Civile 1" në Drejtorinë për Administratë, me numër reference RN00008142, nuk ka ofruar dëshmi me të cilën dëshmohet që ka bërë ankesë të brendshme në Njësinë përgjegjëse ashtu siç parashihet me nenin 25 paragrafin 5 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës i cili përcakton se: „Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual" ndërsa „Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj" ashtu siç parashihet në paragrafin 6 të këtij neni.

Kolegji në bazë të dëshmive të ofruara nga organi i punësimit dhe ankuesi ka gjetur se ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 26.04.2022 për rezultatet e vlerësimit për grupin „Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" për pozitën "Zyrtar për Gjendje Civile 1" në Drejtorinë për Administratë, me numër reference RN00008142, ka parashtruar ankesë me datë 26.05.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj Kolegji në mbështetje të nenit 31 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: "Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli"). 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet", ka konstatuar se ankesa e ankuesit e parashtruar me datë 26.05.2022 në Këshill, është e palejueshme meqenëse ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi të provueshme se i njëjti pavarësisht parashtrimin të ankesës në Këshill të ketë parashtruar ankesë të brendshme kundër vlerësimit përfundimtar të kandidatëve respektivisht kundër njoftimit të datës 26.42022, andaj Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit është e palejueshme ngase nuk ka shteruar procedurat e brendshme të ankesave në organin e punësimit, ashtu siç përcaktohet në nenin 25 paragrafin 5 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, respektivisht ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është në kundërshtim me dispozitat e nenit 31 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 16 paragrafit 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: "Para parashtrimin të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe

nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr. 482/2022

**Rushit KAJTAZI**  
*[Signature]*  
Procesmbajtës

**Malsore Gashi - BAJRAKTARI**  
*[Signature]*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Skenderajt ;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajt; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.